

Bota e Shpirtrave

Lexo tek Alma 40:6–7, 11–14 për të parë atë që Alma i dha mësim Koriantonit. Më pas përdori burimet vijuese për të të ndihmuar ta përgatitësh më tej atë që do të japësh mësim.

Doktrina e Besëlidhje 138:11–13, 18–22, 57

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Parajsë”, scriptures.ChurchofJesusChrist.org

Presidenti Dallin H. Oaks, i Presidencës së Parë, dha mësim:



“Nga shkrimet e shenjta ne dimë se pasi trupat tanë vdesin, ne vazhdojmë të jetojmë si shpirtra në botën e shpirtrave. Shkrimet e shenjta gjithashtu japin mësim se kjo botë e shpirtrave ndahet midis atyre që kanë qenë ‘të drejtë’ ose ‘të vërtetë’ gjatë jetës dhe atyre që kanë qenë të ligj. Ato gjithashtu përshkruajnë mënyrën se si disa shpirtra besnikë ua mësojnë ungjillin atyre që kanë qenë të ligj apo rebelë (shih 1 Pjetër 3:19; Doktrina e Besëlidhje 138:19–20, 29, 32, 37).” (Dallin H. Oaks, “Ki Besim tek Zoti”, *Liahona*, nëntor 2019, f. 26)

Përgatit se si do t’i shpjegoje përgjigjet për pyetjet vijuese:

- Çfarë ndodh me shpirtrat tanë kur vdesim?
- Si është në parajsë? Si është në zonën që Alma e quan “errësir[a] e mëtejshme”, por që gjithashtu quhet burgu i shpirtrave (1 Pjetër 3:19) ose ferri (2 Nefi 9:12)?
- Si mund ta rritë të mësuarit rreth parajsës dhe burgut mirënjohjen tonë për Shpëtimtarin?
- Si mund të na bekojë njohuria jonë për botën e shpirtrave gjatë jetës sonë në vdekshmëri?

Kur jep mësim, sigurohu që ta bësh të qartë se midis vdekjes dhe ringjalljes, shpirtrat e të drejtëve banojnë në parajsë dhe shpirtrat e të ligjve banojnë në burgun e shpirtrave. Trego se si kuptueshmëria jote për këtë të vërtetë ndikon në zgjedhjet që bën në këtë jetë.